POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Scholz telefonon Putin: Të tërhiqen trupat sa më shpejt nga Ukraina! Të gjejmë një zgjidhje diplomatike

2

Homazhet për Azem Hajdarin, Rudina Hajdari: Ishte ndër figurat më të pastra që i shërbeu Shqipërisë

3

Si do të ndahen 560 milionë euro që Elizabeth II la trashëgimi! Harry 'me dhimbje koke', Kate Middleton fatlume! Ja vendimi për Meghan Markle

4

Tiranë/ Po kalonte rrugën, kamioni përplas për vdekje 35-vjeçaren në zonën e Astirit

5

Numër i ulët i pjesëmarrësve, Report Tv sjell pamje me dron nga protesta e Metës (VIDEO)

Kronikë

Misteri i atentatit në Durrës! Qëllohet në drejtim të makinës së maqedonasit, pranë kaloi një person me precedent penal, i shoqëruar nga nipi i ish-ministrit të LSI

Policia e Durrësit njoftoi pas 24 orësh një antentat të ndodhur në qytetin bregdetar, por që nuk la asnjë të lënduar. Sipas bluve të Durrësit, rreth orës 12:00 të 12 shtatori në lagjen numër 13 në rrugën 'Pavarësia' u qëllua një herë me armë zjarri në drejtim të një automjeti në pronësi të një 52-vjeçari me banim në Maqedoninë e Veriut.

Redaksia
13 Shtator, 10:25 | **Përditesimi: 13 Shtator, 13:13**

Policia e Durrësit njoftoi pas 24 orësh një antentat të ndodhur në qytetin bregdetar, por që nuk la asnjë të lënduar. Sipas bluve të Durrësit, rreth orës 12:00 të 12 shtatori në lagjen numër 13 në rrugën 'Pavarësia' u qëllua një herë me armë zjarri në drejtim të një automjeti në pronësi të një 52-vjeçari me banim në Maqedoninë e Veriut. Nga hetimet, policia thotë se u identifikua automjeti me të cilin ka lëvizur personi që qëlloi ndaj makinës së parkuar, pa pasur asnjë person brenda saj. Emri i maqedonasit Bujar Alushi është krejtësisht i panjohur për autoritetet dhe pa precedentë penalë.

Teksa policia thotë se nuk mund të japë detaje të tjera për arsye hetimi, burime jo zyrtare thanë për Report Tv se në të njëjtin moment dhe në të njëjtin vend ku ishte parkuar makina, kanë lëvizur me automjet Mercedez Benz një person me precedentë të theksuar kriminalë me inicialet A.N, që sipas të njëjtave burimeve ishte nën shoqërinë e nipi i një ish-ministri të LSI-së.

Durrës - Finalizohet operacioni policor i koduar "Stacioni"

LEXO EDHE:
Transportonte 5 kallëpë lëndë eksplozive C4 dhe 5 kapsolla detonatore, arrestohet 44-vjeçari në Shijak

Nga ky fakt, lihen dyshime se shënjestër e atentatit mund të kenë qenë ndonjë nga personat që kaluan në zonë, por policia është treguar mjaft e rezervuar për ngjarjen të cilën e bëri publike vetëm pasi mediat nisën të shkruajnë.

> ***Njoftimi i policisë***
>
> *Më datë 12.09.2022, rreth orës 12:00, në lagjen nr. 13, Durrës, në rrugën "Pavarësia", është qëlluar një herë, me armë zjarri, në drejtim të një automjeti të parkuar, në pronësi të shtetasit B. A., 52 vjeç, banues në Maqedoninë e Veriut. Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore dhe profesionale është bërë i mundur identifikimi i automjetit me të cilin ka lëvizur personi që ka qëlluar në drejtim të automjetit të parkuar.*
>
> *Vijon puna intensive për kapjen e autorit. Për arsye hetimi, nuk bëjmë me dije të dhëna të tjera. Theksojmë se në momentin e të shtënës me armë, në automjet nuk ka qenë asnjë person. Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vijon punën për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.*

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 12:20

Policia sqaron të shtënat me armë në Durrës: Qëlloi drejt një automjeti të parkuar! Po punojmë për kapjen e autorit

24 orë pas të shtënave me armë në Durrës ka reaguar policia duke sqaruar se ditën e djeshme, rreth orës 12:00 në rrugën "Pavarësia", është qëlluar një herë, me armë zjarri, në drejtim të një automjeti të parkuar, në pronësi të shtetasit B. A., 52 vjeç, banues në Maqedoninë e Veriut.

Është bërë i mundur identifikimi i automjetit me të cilin ka lëvizur personi që ka qëlluar në drejtim të automjetit të parkuar. Si rezultat i hetimeve, forcat blu nuk bëjnë me dije të dhëna të tjera ndërsa vijon puna intensive për kapjen e autorit.

"Theksojmë se në momentin e të shtënës me armë, në automjet nuk ka qenë asnjë person", njofton policia.

Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vijon punën për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

A.M./K.T./Shqiptarja.com

TAG: atentat Durres

Komente

eri: 13/09/2022 11:10
o cun durrsi rrumi me pojen a jan miq bashk ? kush mbizotro sot ne durres ??

> **eri:** 13/09/2022 14:42
> humbje do kesh po poja kontrollon sot portin ebon daljet me tfuqishme ...
>
> **Vlora:** 13/09/2022 14:10
> Ore mbureni me vrasjet qe bejn vlonjatet ju Ore sa te ket Doqen dhe çipurin Poja ska vdekje
>
> **Eri 2:** 13/09/2022 13:56
> Maneci qe u vra ne sukth para ca kohesh shoku me i ngusht i pojes ja qe dhe aq i paprekshem nuk esht
>
> **eri:** 13/09/2022 13:38
> poja esht sot per sot ne durres me nipin e vet .. kan kriju lidhje tforta me a.l ne tiran e jan bo shum tfort plus po i mundin me shtet kundershtart e vet shullazin me kompani
>
> **O er:** 13/09/2022 11:47
> Ata jan nga njeri krah ne krahun tjeter esht lenti juli marjeli dhe kili qe e qellun dje po se vran dot

Cun durrsi: 13/09/2022 10:57
O lento ca boni kshu m ju kan mor para rrumi me pojen

> **Per durrsin:** 13/09/2022 11:59
> Po njonit n sukth para ca kohesh nga i erdhi dhurata? mos fol kur zdi gjo hahaha

Cun durrsi: 13/09/2022 10:54
O lento a jeni n terezi m ca boni kshu ju ka mor rrumi me pojen para a sju vje turp

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Jeni dakord me propozimin e PD-së për zhdukjen e veprave të artit të krijuara gjatë diktaturës?

PO JO NUK E DI

Lajme të tjera

Sociale

Fushë-Krujë, apeli i nënës së dy fëmijëve jetimë: Më ndihmoni! Burri më vdiq, shtëpia po shembet

Julian Shota
13 Shtator, 11:32

Kronikë

Durrës - Finalizohet operacioni policor i koduar "Ring"
Durrës/ Transportuan 2275 ton naftë kontrabandë me anije çisternë nga Libia në Shqipëri, 4 në pranga, 3 libian dhe 1 sirian
13 Shtator, 11:09

Sociale

527 turistë amerikanë mbërrijnë në Durrës me kroçierën 'Nautica', do vizitojnë qendrat muzeale dhe arkeologjike (VIDEO)
13 Shtator, 10:06

Kronikë

Merr flakë në ecje makina në Durrës, Report Tv sjell videon
12 Shtator, 20:32

Kronikë

U dyshua se ishte mbushur me naftë kontrabandë nga rebelet në Bengazi i Libisë, ndalohet për kontroll anija në Portin e Durrësit! Rezulton e rregullt
12 Shtator, 19:02

Kronikë

Arrestohen dy persona në Durrës! 28-vjeçari dhunoi të ëmën, 41-vjeçarit iu gjet kokainë në makinë
12 Shtator, 11:07

Sociale

12 gjimnaze dhe shkolla 9-vjecare në rindërtim në Durrës, problem mësimi me turne
12 Shtator, 11:05

Kronikë

U arrestua pasi nuk kishte shlyer dënimin për armëmbajtje pa leje, Apeli në Durrës liron Ballist Morinën
12 Shtator, 10:43

Kronikë

Operacion 'blic' në Krujë, Policia në kërkim të personave të rrezikshëm kriminalë
10 Shtator, 23:03

Kronikë

Kontrabanda e naftës në Durrës, Gjykata vendos masat e sigurisë! 20 ditë burg për kapitenin e anijes, i lirë i vëllai

Aldo Mustafa
10 Shtator, 15:31

Kronikë

U ndërtuan pa leje e zaptuan hapësirat publike, nis puna për prishjen e lokaleve në hyrje Durrësit (VIDEO)
9 Shtator, 10:07

Kronikë

Antikontrabanda Detare në Durrës bllokon peshkarexhën 'Leon' me 25 mijë litra naftë, do hidhej në treg! Pranga kapitenit e marinarit
7 Shtator, 08:04

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje